

20252584986

Në bazë të nenit 39 paragrafi (1) të Ligjit për arsimin e mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 229/20, 78/25, 132/25 dhe 250/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës, miratoi

**RREGULLORE PËR MËNYRËN E PARAQITJES, DHËNIES, PËRSHTATJES PËR
NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, ORGANIZIMIT TË DHËNIES DHE
VLERËSIMIT TË PROVIMEVE TË MATURËS SHKOLLORE NË GJIMNAZE,
MATURËS SHKOLLORE PROFESIONALE DHE MATURËS
SHKOLLORE TË ARTEVE**

I. DISPOZITË E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përshkruhet mënyra e paraqitjes, dhënies së provimeve, përshtatjes për nxënësit me aftësi të kufizuara, organizimi dhe vlerësimi i provimeve në maturën shkollore në gjimnaze, maturën shkollore profesionale dhe maturën shkollore të arteve.

**II. PARAQITJA E PROVIMEVE TË MATURËS SHKOLLORE NË GJIMNAZE, MATURËS
SHKOLLORE PROFESIONALE DHE MATURËS SHKOLLORE TË ARTEVE**

Neni 2

Për dhënien e maturës shkollore në gjimnaze / maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit, nxënësi (në tekstin e mëtejshëm: kandidati) paraqitet me parashtrimin e fletëparaqitjes në shkollën në të cilën është i regjistruar, më së voni 60 ditë para fillimit të afatit të provimeve të qershorit dhe më së voni 30 ditë para fillimit të afatit të provimeve të gushtit dhe afatit të provimeve që zhvillohet gjatë pushimit dimëror.

Neni 3

(1) Kandidati ndaj fletëparaqitjes nga neni 2 i kësaj rregulloreje, dorëzon edhe dëftesat për përfundimin e vitit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të arsimit si dëshmi për përmbushjen e kushteve për dhënien e maturës shkollore në gjimnaze/maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit, më së voni tri ditë para fillimit të afatit të provimeve.

(2) Dëshmitë nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk kërkohen për dhënien e detyrës projektuese.

Neni 4

(1) Arsyet e justifikuara për mosparaqitjen në kohë për dhënien e maturës shkollore në gjimnaze/maturës shkollore profesionale / maturës shkollore të artit, mund të jenë:

- kandidati gjatë vitit aktual është shkolluar jashtë vendit (dëshmi – dëftesë e nostrifikuar për përfundimin e vitit të katërt);
- gjatë 30 ditëve të fundit nga paraqitja, kandidati ka qenë i sëmurë (dëshmi – vërtetim nga institucioni përkatës);
- fletëparaqitja është dërguar me postë dhe ka vonuar ose është humbur (dëshmi – vërtetim për dërgimin e dërgesës së rekomanduar);

- për shkak të masës disiplinore, kandidati është përjashtuar nga shkolla ku është paraqitur me kohë (dëshmi – fletëparaqitja e dorëzuar nga shkolla prej ku është përjashtuar ose vërtetim se është paraqitur);

- arsye tjera me dëshmi përkatëse për të cilat komisioni do të konstatojë se janë të justifikuara.

(2) Nëse kandidati, për arsye të justifikuara nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk e ka paraqitur me kohë provimin, Komisioni i Maturës së Shkollës (në tekstin e mëtejshëm: KMSH), mbi bazën e dëshmive me shkrim për arsyetimin e arsyeve nga paragrafi (1) i këtij neni, mund t'i mundësojë të njëjtin ta paraqet më së voni tri ditë para fillimit të afatit të provimit.

(3) Kandidati për arsyet nga paragrafi (2) i këtij neni, duhet të dorëzojë dëshmi me shkrim te KMSH.

Neni 5

Kandidati me statusin e nxënësit të çrregullt paraqitet në shkollë që realizon planin dhe programet mësimore sipas të cilave është arsimuar më parë, në përputhje me afatet për paraqitjen nga neni 2 të kësaj rregulloreje.

III. DHËNIA E PROVIMEVE TË MATURËS SHKOLLORE NË GJIMNAZE, MATURËS SHKOLLORE PROFESIONALE DHE MATURËS SHKOLLORE TË ARTIT

Neni 6

(1) Matura shkollore në gjimnaze/matura shkollore profesionale/matura shkollore e artit jepet në pajtim me Konceptin për provimet në fund nga arsimi i mesëm.

(2) Matura shkollore në gjimnaze/matura shkollore profesionale/matura shkollore e artit jepet në tri afate provimesh: afatin e qershorit, gushtit dhe afatin që realizohet gjatë pushimit dimëror.

(3) Kandidati që për herë të parë e jep provimin e maturës shkollore në gjimnaze / maturës shkollore profesionale / maturës shkollore të artit, e jep atë në tërësi në të njëjtin afat provimesh. Provimet e maturës shkollore në gjimnaze / maturës shkollore profesionale / maturës shkollore të artit që kandidati nuk i ka kaluar, i jep në afatin e ardhshëm të provimeve.

(4) Kandidati me aftësi të veçanta, mund të jap një pjesë të provimeve në më shumë se një afat provimesh.

Neni 7

Terminet për dhënien e maturës shkollore në gjimnaze/ maturës shkollore profesionale/ maturës shkollore të artit publikohen në tabelën e shpalljeve të shkollës më së voni dy javë para fillimit të provimeve.

Neni 8

(1) Kandidati në një ditë mund të japë maksimumi një provim.

(2) Provimet e maturës shkollore/maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit mund të organizohen edhe të shtunën.

Neni 9

(1) Arsye të justifikuara për mungesë në provim, ndërprerje të provimit ose mungesë në maturën shkollore në gjimnaze / maturën shkollore profesionale / maturën shkollore të artit janë:

- sëmundja ose trajtimi mjekësor;

- rrethana të jashtëzakonshme: fatkeqësi natyrore, aksident i kandidatit ose i një anëtar i familjes së ngushtë (aksident trafiku me pasoja të rënda), përkeqësim i gjendjes shëndetësore gjatë provimit etj.

- arsye të tjera të justifikuara (gara ndërkombëtare, paraqitje publike jashtë shtetit, konkurse etj.)

(2) Nëse kandidati nga arsye të justifikuara nga paragrafi (1) të këtij neni, nuk paraqitet në provim ose e ka ndërprerë provimin, KSHM ka ndërprerë provimin, KMSH në bazë të dëshmime me shkrim mund t'i mundësojë që ta japë provimin në të njëjtën sesion.

(3) Kandidati për arsyet nga paragrafi (2) të këtij neni, duhet të paraqesë dëshmi me shkrim pranë KMSH-së.

Neni 10

(1) Komisioni shkollor lëndor (në tekstin e mëtejshëm: KSHL), përgatit nga dy komplete provimi për provimet nga pjesa e detyrueshme dhe nga pjesa me zgjedhje e maturës shkollore në gjimnaze / maturës shkollore profesionale / maturës shkollore të artit, në bazë të programeve të provimit për lëndët përkatëse.

(2) Kryetari i KSHL kompletet e provimeve i dorëzon deri te kryetari i KMSH-së më së voni tre ditë para fillimit të provimit.

(3) Një komplet provimi për provimin intern përbëhet nga testi, udhëzimi për vlerësim dhe kriteret për shndërrimin e pikëve në nota.

(4) Kryetari i KMSH-së kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë së materialit të provimit dhe për shumëzimin e tyre në numrin e nevojshëm të ekzemplarëve.

(5) Испитниот материјал треба да биде спакуван за секој тестатор во соодветно запечатен плик. Materiali i provimit duhet të jetë i paketuar për çdo testues në zarfin e mbyllur në mënyrë përkatës.

(6) Një orë para fillimit të provimit, kryetari i KMSH-së e dorëzon materialin e provimit te kryetarit i KSHL-së, ndërsa ai testuesve.

Neni 11

Maturën shkollore në gjimnaze/maturën shkollore profesionale/maturën shkollore të artit kandidati e jep në shkollë në të cilën e ka përfunduar vitin e fundit të arsimit.

Neni 12

(1) Kandidati, më së voni një muaj para fillimit të afatit të provimit për të cillin është paraqitur njihet me procedurat për realizimin e provimeve.

(2) Kryetari i KMSH-së kujdeset për informimin e saktë dhe me kohë të kandidatëve.

Neni 13

(1) Kohëzgjatja e çdo provimi përcaktohet me programin përkatës të provimit.

(2) Gjatë zhvillimit të provimeve mbahet procesverbal.

Neni 14

(1) KMSH-ja, për pjesën e detyrueshme dhe pjesën me zgjedhje të provimit, më së voni një javë para provimit, harton orarin e kandidatëve sipas ambienteve.

(2) Listat për orarin e kandidatëve sipas ambienteve publikohen nga KMSH-ja në tabelën e shpalljeve të shkollës ose në një vend tjetër të dukshëm, të qasshëm për kandidatët, një ditë para provimit.

(3) Të dhënat për orarin e kandidatëve sipas ambienteve, deri në publikimin e tyre në tabelën e shpalljeve ruhen në fshehtësi.

(4) Kandidatët duhet të jenë para ambientit në të cilin zhvillohet provimi së paku njëzet minuta para fillimit të provimit.

(5) Kandidati i cili është vonuar në provim më shumë se 15 minuta nga fillimi i provimit, nuk mund ta japë provimin në atë afat provimi.

(6) Ambientet në të cilat zhvillohet provimi duhet të jenë të përgatitura për zhvillimin e provimit së paku 12 orë para fillimit të provimit.

Nga ambientet duhet të largohen të gjitha mjetet mësimore dhe ndihmëse shkollore.

(7) Për çdo kandidat sigurohen bankë dhe karrige. Distanca ndërmjet dy kandidatëve nuk duhet të jetë më e vogël se 1,5 metra. Të gjitha bankat duhet të jenë të kthyer në të njëjtin drejtim.

(8) KMSH-ja, më së voni një javë para provimit e bën orarin e testatorëve sipas hapësirave dhe për çdo ambient në të cilën ka 15 kandidatë cakton nga një testues. Nëse ambientet janë më të mëdha, caktohet nga një testues për çdo pesëmbëdhjetë kandidatë.

(9) Hapësirat ku zhvillohet provimi duhet të jenë të mëdha, të ndriçuara mirë, të dukshme. Shkolla duhet të sigurojë persona kujdestarë për korridoret dhe të gjitha ambientet e tjera në shkollë.

(10) Kandidati me vete duhet të ketë dokument identifikimi me fotografi.

(11) Kandidatët duhet të kenë me vete mjete shkrimi (stilolaps që shkruan me ngjyrë blu) dhe mjete të tjera të parashikuara me programin e provimit për lëndën përkatëse.

(12) Nëse kandidatët fusin në ambientin e provimit sende personale, duhet t'i lënë paraprakisht të caktuar në vendin e ambientit.

Neni 15

(1) Provimin me shkrim e realizon testuesi në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

(2) Testuesit caktohen nga kryetari i KMSH-së, nga radhët e mësimdhënësve të shkollës.

(3) Testuesi nuk mund të jetë mësimdhënës i lëndës për të cilën realizohet provimi.

Neni 16

(1) Testatori e hap materialin e provimit të mbyllur para kandidatëve.

(2) Gjatë provimit kandidatët duhet t'i dëgjojnë udhëzimet e testatorit, të punojnë në mënyrë të pavarur dhe të mos komunikojnë ndërmjet vete. Çdo shmangie nga e theksuara do të thotë shkelje të rendit të provimit.

(3) Përveç kandidatëve dhe testatorëve, në provim mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë që kanë autorizim me shkrim nga Qendra Shtetërore e Provimeve.

(4) Personat nga paragrafi (3) i këtij neni ndjekin tërë rrjedhën e provimit ose një pjesë të tij.

(5) Gjatë zhvillimit të provimit kandidati mund ta lëshojë ambientin, por jo më shumë se pesë minuta, së bashku me një nga testuesit që është kujdestar në korridor. Ambientin nuk mund ta lëshojë më shumë se një kandidat në të njëjtën kohë.

(6) 30 minutat e para nga fillimi i provimit dhe 15 minutat e fundit para përfundimit të provimit, kandidati nuk mund ta lërë hapësirën e provimit.

(7) Kandidati pas përfundimit të provimit e dorëzon materialin e provimit te testatori dhe largohet nga ambienti.

(8) Provimi përfundon saktësisht në kohën e paraparë, në përputhje me kohëzgjatjen e provimit.

(9) Pas përfundimit të provimit, testatori i kontrollon, i paketon dhe i dorëzon materialet e provimit kryetarit të KMSH-së sipas udhëzimeve të marra.

(10) Testatori përgatit raport për të gjithë rrjedhën e provimit dhe plotëson formularët përkatës

Neni 17

(1) Kandidati i cili shkel rregullat për dhënien e provimit, mund të paralajmërohet ose të largohet nga provimi.

(2) Vërejtjen e shqipton testatori ose kryetari i KSHL-së, kështu që e paralajmëron kandidatin dhe e regjistron në procesverbalin për dhënie të provimit të maturës.

(3) Nëse kandidati pas shqiptimit të dytë të paralajmëruar vazhdon me shkeljen e rregullave për dhënie të provimit, testatori ose kryetari i KSHL-së, përmes testatorit kujdestar në korridor e informon kryetarin e KSHM-së, i cili e largon nga provimi.

(4) Kandidati i cili në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni, do të largohet nga provimi, pas asaj pjese të maturës shkollore në gjimnaze/maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit, nuk do të vlerësohet.

(5) Kandidati që konsideron se është larguar pa arsye nga provimi, mund të paraqesë ankesë pranë KMSH-së.

Neni 18

(1) Temën e detyrës projektuese kandidati mund ta propozojë vetë ose në konsultim me mësimdhënësin mentor, në përputhje me kriteret për vlerësimin e detyrës projektuese në programin e provimit. Detyrën projektuese kandidati e përgatit në mënyrë të pavarur, i udhëhequr nga mësimdhënësi-mentor.

(2) Kandidati në mënyrë të pavarur zgjedh mentorin për detyrën projektuese. Mësimdhënësi mentor mund të ketë më së shumti 30 kandidatë për mentorim.

Neni 19

(1) Kandidati për detyrën projektuese:

- më së voni deri në fund të nëntorit të vitit shkollor në të cilin jep maturën shkollore në gjimnaze/maturën shkollore profesionale/ maturën shkollore të artit, zgjedhë temën e detyrës projektuese;

- më së voni deri në fund të marsit të vitit shkollor në të cilin jep maturën shkollore në gjimnaze/maturën maturën shkollore profesionale/maturën shkollore të artit, dorëzon një ekzemplar të pjesës së shkruar dhe/ose produktit/veprës së përgatitur nga detyra projektuese e përgatitur në KMSH-në, në formë letre dhe në formë elektronike te mentori, i cili pastaj ia dorëzon anëtarëve të tjerë të komisionit për detyrën projektuese.

(2) Shkolla e arkivon ekzemplarin e dorëzuar të detyrës projektuese të kandidatit në formë letre.

Neni 20

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese zhvillohet para komisionit përkatës. Për një kandidat, kohëzgjatja e prezantimit dhe mbrojtjes së detyrës projektuese është maksimumi 20 minuta.

Neni 21

Në realizimin e maturës shkollore në gjimnaze/maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit, marrin pjesë edhe testatorët.

IV. PËRSHTATJA E MATURËS SHKOLLORE NË GJIMNAZE/MATURËS SHKOLLORE PROFESIONALE MATURËS SHKOLLORE TË ARTIT PËR KANDIDATËT ME AFTËSI TË VEÇANTA

Neni 22

(1) Nga KSHM-ja në konsultim me Qendrën Shtetërore të Provimeve, përgatitet dhe përshtatet mënyra e realizimit të pjesëve të maturës shkollore në gjimnaze/maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit.

(2) Përshtatja e maturës shkollore në gjimnaze/maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit për kandidatët me aftësi të veçanta, duhet të jetë në përputhje me përvojën e tyre të fituar gjatë procesit arsimor.

Neni 23

(1) Provimi për kandidatët me aftësi të veçanta, mund të zgjat maksimum 50% më shumë se koha e paraparë për provimin e lëndës përkatëse.

(2) Nga KSHM-ja mund të parashikohet edhe kohë për pushim për kandidatin (pauzë).

(3) Për kandidatin nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, sigurohet ambient i veçantë. Nëse pyetësi është anëtar i jashtëm, sigurohet edhe një anëtar i brendshëm i komisionit dhe një testator i provimit. Testatori i provimit kujdedest që të mos prishet rendi i provimit.

Neni 24

Për kandidatët me aftësi të veçanta, mund të realizohen përshtatjet në vijim:

- lirim për dhënien e një pjese të materialit të provimit;
- përshtatja teknike e materialit të provimit;
- dhënia e provimit me ndihmës;
- përdorimi i mjeteve të veçanta ndihmëse;
- në vend të një provimi me shkrim, një provim me gojë dhe anasjelltas;
- provim i përshtatur me përdorimin e alfabetit të Breit dhe/ ose gjuhës së shenjave;
- përgatitja e përshtatur e detyrës projektuese dhe vlerësimi i saj.

Neni 25

Kandidati me aftësi të kufizuara mund të lirohet nga dhënia e një pjese të materialit të provimit për të cilin nuk është e mundur të përshtatet.

Neni 26

(1) Për kandidatin me pengesa trupore (fizike) ose pengesa të kombinuara, nëse është e nevojshme, sigurohet një person për lexim dhe shkrim të përgjigjeve (ndihmës).

(2) Ndihmësi i kandidatit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të jetë mësimdhënësi ose i afërm i tij.

(3) Ndihmësi i kandidatit nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të jetë një nga anëtarët e komisionit të provimit.

Neni 27

Kandidati me aftësi të veçanta mund të përdorë kompjuter, me ç'rast nuk mund të ketë qasje në asnjë program që mund t'i mundësojë të kalojë më lehtë provimin. Një kopje e përgjigjeve të kandidatit ruhet në një pajisje të jashtme memoruese, ndërsa një kopje tjetër shtypet, dhe më pas kryetari i komisionit të provimit i fshin përgjigjet e kandidatit nga kompjuteri.

Neni 28

Kandidati me vështirësi të rënda në të folur, mund të lirohet nga pjesa gojore e provimit ose të njëjtin ta jep me asistencë nga interpretuesi.

Neni 29

(1) Kandidati me dëmtim të dëgjimit mund të lirohet nga pjesa gojore e provimit ose të njëjtin ta realizojë me ndihmë të interpretuesit në gjuhën e shenjave.

(2) Kandidatit me dëmtim të shikimit duhet t'i sigurohet gjatë provimit të përdorë shkrim të dukshëm (nxënës me shikim të dobët) ose alfabetin e Breit (nxënës të verbër).

Neni 30

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese duhet të përshtaten në mënyrë që kandidati të mund t'i shfaqë njohuritë dhe aftësitë e tij.

Neni 31

(1) Kandidatit me aftësi të veçanta, vlerësimi mund t'i përshtatet në mënyrë përkatëse me përshtatjen e materialit të provimit.

(2) Për shkak të objektivitetit më të madh, rrjedha e provimit mund të regjistrohet në mënyrë të përshtatshme me një procesverbal shtesë.

V. VLERËSIMI I PROVIMEVE TË MATURËS SHKOLLORE NË GJIMNAZE, MATURËS SHKOLLORE PROFESIONALE/MATURËS SHKOLLORE TË ARTIT

Neni 32

Verifikimi dhe vlerësimi i njohurive dhe shkathtësive të kandidatëve nga pjesa e detyrueshme dhe pjesa me zgjedhje nga matura shkollore në gjimnaze/matura shkollore profesionale/matura shkollore e artit, realizohet në mënyrë interne nga komisionet shkollore përkatëse lëndore. Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese, kryhet në mënyrë interne para komisionit shkollor përkatës të detyrës së projektit.

Neni 33

(1) Vlerësimi i njohurive dhe shkathtësive të kandidatëve kryhet me pikë të cilat pastaj shndërrohen në nota nga një (1) deri në pesë (5).

(2) Të gjitha notat janë të kaluese, përveç notës njësh (1).

Neni 34

(1) Kriteret për shndërrimin e pikëve në nota për pjesën e detyrueshme dhe pjesën me zgjedhje të maturës shkollore në gjimnaze / maturës shkollore profesionale / maturës shkollore të artit përgatiten nga KSHL-ja përkatëse para zhvillimit të provimit. Me kriteret përcaktohet numri minimal i pikëve për notë kaluese dhe intervali i pikëve për secilën nga notat kaluese, nga dy (2) deri në pesë (5).

(2) Minimumi për notë kaluese përfshin njohuritë dhe aftësitë më thelbësore që kandidati duhet t'i demonstrojë në provim (në tekstin e mëtejme: pragu i dhënë).

(3) Kriteret për shndërrimin e pikëve në nota për detyrat projektuese përgatiten nga komisioni për detyrën projektuese. Detyra projektuese vlerësohet nga komisioni përkatës shkollor, ashtu që faza përgatitore dhe faza e realizimit vlerësohen nga mësimdhënësi–mentor, ndërsa faza e prezantimit dhe e mbrojtjes vlerësohet nga dy anëtarët e tjerë të komisionit. Në notën për detyrën projektuese, mësimdhënësi–mentor merr pjesë me 50%, ndërsa dy anëtarët e tjerë me nga 25%.

Neni 35

Kandidati ka dhënë maturën shkollore në gjimnaze/maturën shkollore profesionale/maturën shkollore të artit, nëse pas të gjitha provimeve arrin rezultate mbi prapun e dhënë.

Neni 36

(1) Rezultatet e provimeve të maturës shkollore në gjimnaze/maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit ruhen në fshehtësi deri në publikimin e tyre.

(2) Rezultatet publikohen nga KSHM-ja më së voni tre ditë pas përfundimit të provimit të lëndës përkatëse ose pas mbrojtjes së detyrës projektuese.

(3) Nga KSHM-ja publikohen rezultatet nga të gjitha provimet e maturës shkollore në gjimnaze/maturës shkollore profesionale/maturës shkollore të artit.

Neni 37

(1) Kandidati që nuk e ka kaluar maturën shkollore në gjimnaze/maturën shkollore profesionale/maturën shkollore të artit, njoftohet për suksesin e arritur në pjesët e veçanta të maturës.

(2) Provimet në të cilat kandidati nuk ka marrë notë kaluese, i jep në afatet e ardhshme të provimeve dhe, bashkë me paraqitjen për provim, dorëzon vërtetim për provimet e kaluara nga afatet e mëparshme të provimeve.

(3) Kandidatët që në prezantimin dhe mbrojtjen e detyrës projektuese nuk kanë marrë notë kaluese, mund ta japin përsëri provimin në të njëjtën afat provimi.

Neni 38

(1) Kandidati, nëse konsideron se është bërë gabim në vlerësimin e detyrave të provimit, në përllogaritjen e pikëve ose në nxjerrjen e notës, mund të paraqesë ankesë ndaj vlerësimit të provimit pranë KMSH-së.

(2) Ankesa dorëzohet më së voni tri ditë nga dita e publikimit për rezultatet nga provimi.

(3) Ankesa shqyrtohet nga KSHL-ja në prani të një anëtarit nga KMSH-ja më së voni tri ditë nga dorëzimi i ankesës.

(4) Nëse komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni, konstaton se është bërë gabim, në atë rast përcakton një notë të re për çka e njofton kandidatin.

Neni 39

(1) Kandidati që ka kaluar me sukses maturën shkollore në gjimnaze/maturën shkollore profesionale/maturën shkollore të artit dhe dëshiron të përmirësojë suksesin nga një ose më shumë lëndë, mund në afatin e ardhshëm përsëri ta jep dhe të njëjtën të përcaktohet nota që e ka arritur në dhënien e përsëritur.

(2) Dhënien e provimit për përmirësimin e rezultatit kandidati nga paragrafi (1) i këtij neni, mund ta shfrytëzojë vetëm një herë.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje pushon së vlefshmi Rregullorja për mënyrën e dhënies dhe vlerësimit të rezultateve të nxënësve në provimet e maturës shkollore në gjimnaze (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 78/10), Rregullorja për mënyrën e dhënies dhe vlerësimit të rezultateve të nxënësve në provimet e provimit përfundimtar në arsimin e mesëm profesional me kohëzgjatje katërvjeçare (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 78/10) dhe Rregullorja për mënyrën e dhënies dhe të vlerësimit të rezultateve të nxënësve në provimet e maturës shkollore në arsimin e mesëm të artit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 78/10).

Neni 41

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 18-15872/1
17.12.2025
Shkup

Ministër
i Arsimit dhe Shkencës,
Pr. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.